www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2014 – Numri: 180

Tiranë – E Mërkurë, 26 Nëntor 2014

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 686, datë 22.10.2014	Për një ndryshim në vendimin nr. 290, datë 14.5.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e fondeve buxhetore dhe të raportit të përbashkët të Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Ministrisë së Financave, për realizimin e platformës multimediatike "Branding Albania"" ……	9287
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 719, datë 31.10.2014	Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural ……..	9287
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 754, datë 12.11.2014	Për disa ndryshime në vendimin nr. 419, datë 15.5.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë", të ndryshuar ……	9288
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 755, datë 12.11.2014	Për përcaktimin e procedurave e të kushteve për dhënien e "Licencës së përpunimit" për impiantet e përpunimit të nënprodukteve të naftës……	9289
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 756, datë 12.11.2014	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2014, miratuar për Ministrinë e Integrimit Evropian, për përballimin e TVSH-së, në kuadër të projektit "Green Boat", financuar nga Bashkimi Evropian nëpërmjet fondeve IPA……	9292
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 757, datë 12.11.2014	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Kulturës, për Teatrin Kombëtar të Operës dhe Baletit e Ansamblin Popullor, të objekteve dhe truallit funksional, me sipërfaqe të përgjithshme 11 754.2 m^2, pjesë e pronës nr. 109, me emërtim "Sh.a. Riparim artilerie", me vendndodhje në Brar, Tiranë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar…….	9292

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 758, datë 12.11.2014	Për kalimin në pronësi, pa shpërblim, nga Ministria e Mbrojtjes te misioni i bamirësisë "Motrat e Nënë Terezës", të pronës nr. 1218, me emërtim "Spitali dhe SHLU", me vendndodhje në Pukë, si dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar……	9295
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 760, datë 12.11.2014	Për një shtesë në vendimin nr. 439, datë 2.7.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave të legalizimit të ndërtimeve pa leje, shtesave anësore apo në lartësi, të ndërtuara nga shoqëria "Hawai-Alb" sh.p.k."……..	9296
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 761, datë 12.11.2014	Për shfuqizimin e vendimit nr. 637, datë 21.5.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për ndryshimin e tarifave të transportit qytetas të udhëtarëve, të miratuara me vendimin nr. 146, datë 26.2.1998, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar"……..	9296
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 762, datë 12.11.2014	Për mënyrën e organizimit dhe të dhënies së kujdesit për shëndetin mendor për personat që gjenden në institucionet rezidenciale të përkujdesjes sociale……..	9296
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 763, datë 12.11.2014	Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit, në programet e specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë të studimeve, në fushën e mjekësisë, për vitin akademik 2014 - 2015…….....	9297
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 764, datë 12.11.2014	Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të shërbimeve në qendrat spitalore universitare……	9300
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 765, datë 12.11.2014	Për një ndryshim në vendimin nr. 46, datë 29.1.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave"……..	9300
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 766, datë 12.11.2014	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2014, miratuar për Gjykatën Kushtetuese……..	9301
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 767, datë 12.11.2014	Për shpalljen "Qendër historike" të një zone në qytetin-muze të Beratit dhe miratimin e rregullores "Për mbrojtjen, konservimin e integruar, administrimin e "Qendrës historike" dhe zonës së mbrojtur të qytetit të Beratit"……..	9301
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 768, datë 12.11.2014	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i venddepozitimit sanitar të mbetjeve në afërsi të Maliqit dhe rrugës hyrëse, qarku Korçë……..	9308
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 769, datë 12.11.2014	Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë të pasurisë së paluajtshme, të ndodhur në zonën kadastrale nr. 8380, me numër pasurie 6/145, për Gjykatën Kushtetuese....……	9313

VENDIM
Nr. 686, datë 22.10.2014

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 290, DATË 14.5.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E FONDEVE BUXHETORE DHE TË RAPORTIT TË PËRBASHKËT TË MINISTRISË SË ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT, MINISTRISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES DHE MINISTRISË SË FINANCAVE, PËR REALIZIMIN E PLATFORMËS MULTIMEDIATIKE "BRANDING ALBANIA""

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", dhe të nenit 13, të ligjit nr. 185/2013, "Për buxhetin e vitit 2014", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, të ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shkronja "b", e pikës 3, të vendimit nr. 290, datë 14.5.2014, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"b. Faza e dytë, me vlerë 500 000 (pesëqind mijë) euro, do të realizohet pas lidhjes së kontratës me kompaninë fituese dhe do të përballohet nga fondi i kontingjencës për vitin 2014.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 719, datë 31.10.2014

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", dhe të nenit 21, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural", me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, si agjencia e pagesave, në kuptim të nenit 21, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural", është person juridik publik në varësi të ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

2. Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural e ka selinë në Tiranë dhe ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural ofron shërbime të drejtpërdrejta për fermerët vendas dhe zbaton politikat shtetërore për zhvillimin bujqësor dhe rural në Republikën e Shqipërisë.

4. Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural është përgjegjëse për administrimin e fondeve të programeve për bujqësinë dhe për zhvillimin rural, si më poshtë vijon:

a) Fondeve të buxhetit të shtetit;

b) Fondeve kundërparti, të projektit 2KR;

c) Fondeve të Bashkimit Evropian;

ç) Fondeve të siguruara nga shtete apo organizma të tjerë me qëllim zhvillimin bujqësor e rural në Shqipëri.

5. Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural ka për detyrë:

a) të vërë në zbatim masat e politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural, si dhe masa të tjera të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore, nëpërmjet:

i) ofrimit të shërbimeve ndihmëse për fermerët dhe shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor që ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë, në seli dhe në terren;

ii) orientimit të veprimtarisë së fermerëve në përputhje me drejtimet e përcaktuara nga Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave;

iii) zhvillimit të procedurave konkurruese për fermerët dhe mbështetjes së drejtpërdrejtë të tyre me subvencione të ndryshme;

b) të hartojë raportet dhe analizat, në përputhje me zhvillimin e bujqësisë;

c) të organizojë ngritjen dhe funksionimin e sistemeve të integruara të administrimit dhe të kontrollit;

ç) të krijojë dhe të mirëmbajë bazën e të dhënave të nevojshme;

d) të zbatojë masat e kontrollit dhe auditit të brendshëm;

dh) të organizojë ngritjen dhe zbatimin e sistemeve të informimit të tregut;

e) të inspektojë fermerët dhe subjektet, që kanë përfituar nga fondet e programeve për zhvillimin bujqësor dhe rural.

6. Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural harton dhe ndjek planin e veprimit për përafrimin e strukturës organizative dhe të kapaciteteve të saj menaxhuese dhe teknike me standardet e akreditimit të Bashkimit Evropian.

7. Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm, i cili përfaqëson agjencinë, si dhe organizon e drejton të gjithë veprimtarinë e saj.

8. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural emërohet, lirohet ose shkarkohet nga Kryeministri, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

9. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të AZHBR-së rregullohen në bazë të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.

10. Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, e krijuar me vendimin nr. 1443, datë 31.10.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR), si agjenci e pagesave", vazhdon funksionimin e saj me miratimin e këtij vendimi.

11. Struktura dhe organika e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, miratuar me urdhrin nr. 67, datë 13.2.2014, të Kryeministrit, mbeten në fuqi deri në miratimin e strukturës dhe organikës së re me urdhër të Kryeministrit, sipas organizimit të miratuar me këtë vendim.

12. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, i emëruar sipas vendimit nr. 1443, datë 31.10.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR), si agjenci e pagesave", vazhdon detyrën me miratimin e këtij vendimi.

13. Rregullat dhe procedurat e funksionimit të brendshëm të Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, si dhe ndarja e detyrave, përgjegjësive dhe kompetencave, ndërmjet saj e drejtorive të bujqësisë dhe institucioneve të tjera përcaktohen me udhëzim të ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

14. Vendimi nr. 1443, datë 31.10.2008, i Këshillit të Ministrave, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR), si agjenci e pagesave", shfuqizohet.

15. Në lidhjen nr. 1, që përmendet në pikën 3, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", ndarja me numër rendor 20 shfuqizohet.

16. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 754, datë 12.11.2014

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 419, DATË 15.5.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KRIJIMIN E FONDIT SHQIPTAR TË KONKURRUESHMËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4, 6, shkronjat "a", "b", "d", "e", e 7, pika 1, të ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002, "Për ndërmarrjet e vogla e të mesme", të ndryshuar, dhe të neneve 17 e 18, të ligjit nr. 10303, datë 15.7.2010, "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)", me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 419, datë 15.5.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"4. Pagesa e subvencionit të bëhet 50% me miratimin e projektit dhe 50% në fund të zbatimit të tij. Pagesa në fund të projektit do të bëhet kundrejt faturave të shpenzimeve të kryera për vlerën totale të projektit.".

b) Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"5. Fondi Shqiptar i Konkurrueshmërisë zbatohet për periudhën tre vjeçare 2013, 2014 dhe 2015. Për vitin 2013 ai ka vlerën prej 20 000 000 (njëzet milionë) lekësh, për vitin 2014 vlera e fondit do të jetë 26 000 000 (njëzet e gjashtë milionë) lekë dhe për vitin 2015 vlera do të jetë 28 000 000 (njëzet e tetë milionë) lekë.".

2. Fondi prej 6 000 000 (gjashtë milionë) lekësh, që do të shtohet për vitin 2014, të përballohet nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes/AIDA-n, për vitin 2014.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 755, datë 12.11.2014

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE E TË KUSHTEVE PËR DHËNIEN E "LICENCËS SË PËRPUNIMIT" PËR IMPIANTET E PËRPUNIMIT TË NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12/1, 17 e 18/1, të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndërtimi dhe funksionimi i impianteve të përpunimit të nënprodukteve të naftës bëhet nga personat juridikë, pasi ato të jenë pajisur me "Licencën e përpunimit", të lëshuar nga ministria përgjegjëse për hidrokarburet (Ministria), sipas procedurave dhe kushteve të përcaktuara në këtë vendim.

2. Personat juridikë, subjektet aplikuese, paraqesin në ministri kërkesën për t'u pajisur me "Licencën e përpunimit", shoqëruar me dokumentet e mëposhtme:

a) Ekstraktin historik dhe tregtar të regjistrit tregtar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, që vërteton se personi juridik është krijuar në formën e shoqërisë aksionare, ku në objekt të ketë të përcaktuar veprimtarinë për përpunimin e nënprodukteve të naftës;

b) Dokumentin që vërteton se subjekti nuk është në proces falimentimi, sipas parashikimeve të ligjit për falimentimin;

c) Projektin teknologjik që do të zbatohet për ndërtimin e impiantit të përpunimit dhe ambienteve të depozitimit dhe/ose magazinimit të nënprodukteve të naftës, përfshirë edhe projektin e mbrojtjes ndaj zjarrit, të miratuar nga Inspektorati Shtetëror Përgjegjës. Projekti duhet të përmbajë të dhëna për bilancin material dhe treguesit financiarë të impiantit që do të ndërtohet;

ç) Kartën teknologjike me parametrat e punës, lëndët e para dhe produktet përfundimtare të përfituara sipas standardeve të përcaktuara më parë. Karta teknologjike duhet të jetë e miratuar nga Inspektorati Shtetëror Përgjegjës;

d) Studimin paraprak të fizibilitetit për veprimtarinë që do të realizojë shoqëria;

dh) Lejen e mjedisit të veprimtarisë, të lëshuar nga organi përgjegjës;

e) Dokumentet me të dhënat e nevojshme për vendin e ushtrimit të veprimtarisë, si skemë-ideja e genplani, dhe dokumente që provojnë raportin me truallin ku do të ushtrohet veprimtaria, si certifikatë pronësie, kontratë qiraje etj., për një periudhë jo më të vogël se koha e vlefshmërisë së "Licencës së përpunimit" për impiantin e përpunimit e magazinën që do të përdorë;

ë) Dokumentin që vërteton se vendi i parashikuar për ndërtimin e impiantit të përpunimit është i përcaktuar për ndërtimin e objekteve të kësaj natyre në një nga instrumentet e planifikimit të territorit, në përputhje me ligjin nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit". Në rast se aplikimi për licencim bëhet nga subjektet, të cilat kanë ndërtuar impiantin në një periudhë të mëparshme kohore, referuar kërkesave të nenit 15, të ligjit nr. 71/2014, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, subjekti aplikues është i detyruar të paraqesë lejen përkatëse të ndërtimit të objektit në përputhje me legjislacionin në fuqi;

f) Skemën e funksionimit të impiantit të miratuar nga Inspektorati Shtetëror Përgjegjës;

g) Kontratën e punësimit të drejtuesit teknik që do të ndjekë realizimin e projektit të impiantit dhe vënien në përdorim të tij;

gj) Dokumente në formën e një letre komforti, marrëveshjeje paraprake kreditimi ose çdo dokument tjetër, që vërtetojnë mbështetjen financiare të projektit nga institucione financiare ose bankat vendase a të huaja, ku përcaktohen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacione apo financime të tjera) për ndërtimin e impiantit të përpunimit;

h) Dokumentin që vërteton se subjekti aplikues nuk është dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për aktivitetin e shoqërisë, lëshuar nga gjykata;

i) Dokumentin që vërteton se përfaqësuesi i subjektit aplikues nuk ndodhet në ndjekje penale, lëshuar nga prokuroria;

j) Dokumentin që vërteton se subjekti aplikues i ka plotësuar detyrimet fiskale, lëshuar nga administrata tatimore;

k) Dokumentin që vërteton se subjekti aplikues i ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore, lëshuar nga administrata tatimore;

l) Të dhëna për kapacitetet depozituese në projektin e ndërtimit të impiantit të përpunimit. Për këtë, subjekti aplikues duhet të provojë se kapaciteti minimal i depozitimit dhe/ose magazinimit të nënprodukteve të naftës që do të prodhojë impianti i përpunimit, duhet të jetë në përputhje me kërkesat për kapacitet më të vogël depozitimi që kërkohet për shoqëritë që pajisen me licencë tregtimi (me shumicë), sipas legjislacionit në fuqi.

Dokumentet vërtetuese duhet të jenë të përpiluara në gjuhën shqipe, origjinale ose fotokopje të noterizuara. Për dokumentet e përkthyera në gjuhën shqipe, vërtetimi i nënshkrimit të përkthyesit bëhet nga noteri.

3. Në bazë të parashikimeve të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, subjektet juridike, që aktualisht kanë ndërtuar impiante dhe operojnë në veprimtarinë e përpunimit të nënprodukteve të naftës, janë të detyruara:

a) të aplikojnë për licencim, duke plotësuar kushtet e përcaktuara në këtë vendim;

b) të paraqesin të gjithë dokumentacionin e përcaktuar në pikën 2, të këtij vendimi, përveç dokumentit të përcaktuar në shkronjën "gj", po të pikës 2.

4. Për verifikimin e dokumentacionit dhe plotësimin e kushteve të përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi, me urdhër të ministrit përgjegjës për hidrokarburet ngrihet komisioni i shqyrtimit të aplikimeve, i përbërë nga 7 (shtatë) anëtarë me përvojë në fushën hidrokarbure, juridike dhe ekonomike.

5. Komisioni i shqyrtimit të aplikimeve shqyrton dokumentacionin brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e paraqitjes dhe, kur e çmon të arsyeshme dhe brenda afatit të shqyrtimit, ka të drejtë të kërkojë sqarime apo të dhëna shtesë nga aplikuesi, të realizojë verifikime të të dhënave pranë institucioneve të tjera, si dhe të verifikojë në terren elemente të caktuara të projektit e të vendndodhjes së impiantit që do të ndërtohet, etj.

6. Kur nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe verifikimet e kryera në institucionet e tjera dhe/ose në terren rezulton se nuk plotësohen kushtet e kërkuara, komisioni i shqyrtimit të aplikimeve harton një raport dhe njofton subjektin aplikues për dokumentacionin që mungon dhe të drejtën e tij për të plotësuar dokumentacionin dhe kushtet përkatëse jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendarike nga dërgimi fillestar i njoftimit.

Subjekti aplikues ka të drejtë të riparaqesë aplikimin me dokumentacionin e plotësuar brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e njoftimit. Komisioni i shqyrtimit të aplikimeve mblidhet dhe merr vendim brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga dita e depozitimit të dokumentacionit të plotësuar ose brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga dita e përfundimit të afatit të depozitimit, nëse subjekti aplikues nuk ka bërë plotësimin e dokumentacionit.

7. Në rast se subjekti aplikues nuk plotëson dokumentacionin dhe kushtet përkatëse brenda afatit të përcaktuar në pikën 6 ose kur dokumentacioni i plotësuar brenda afatit ka mangësi, e si pasojë, aplikimi nuk është në përputhje me kushtet e përcaktuara, komisioni i shqyrtimit të aplikimeve harton një raport vlerësimi dhe i propozon ministrit refuzimin e licencës për aktivitetin e impiantit të përpunimit të nënprodukteve të naftës. Ministri i njofton subjektit aplikues refuzimin e aplikimit për

dhënien e "Licencës së përpunimit" të nënprodukteve të naftës, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga data e propozimit të paraqitur nga komisioni i shqyrtimit të aplikimeve.

Në këtë rast, subjekti i interesuar ka të drejtë të paraqesë ankim në gjykatën kompetente, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni për refuzimin e aplikimit.

Subjekti aplikues ka të drejtë të riparaqesë në çdo kohë aplikimin me dokumentacionin e plotësuar.

8. Kur nga shqyrtimi i dokumentacionit të aplikimeve brenda afateve të përcaktuara në pikën 5 dhe, sipas rastit, në pikën 6, rezulton se plotësohen kushtet e kërkuara, komisioni i shqyrtimit të aplikimeve harton një raport vlerësimi dhe i propozon ministrit miratimin e licencës për aktivitetin e impiantit të përpunimit të nënprodukteve të naftës. Ministri miraton "Licencën e përpunimit" të impiantit, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga data e propozimit të paraqitur nga komisioni i shqyrtimit të aplikimeve.

9. Në dokumentin e "Licencës së përpunimit" të nënprodukteve të naftës përcaktohen:

a) numri dhe data e miratimit të licencës dhe e hyrjes në fuqi;

b) emri, selia e subjektit dhe të dhënat për regjistrimin si person juridik;

c) vendi ku ushtrohet veprimtaria e impiantit për përpunimin e nënprodukteve të naftës;

ç) emërtimi teknologjik dhe parametrat teknikë e teknologjikë të impiantit të përpunimit të nënprodukteve të naftës, si dhe standardet e përpunimit të nënprodukteve të naftës;

d) afati i përgatitjes së dokumenteve sipas pikës 10, të këtij vendimi, afati i vlefshmërisë së "Licencës së përpunimit", si dhe e drejta për rinovim të licencës.

dh) të dhënat që duhet të paraqesë perio-dikisht subjekti i licencuar gjatë ushtrimit të veprimtarisë së përpunimit të nënprodukteve të naftës.

Në dokumentin e "Licencës së përpunimit" të nënprodukteve të naftës mund të përcaktohen edhe elemente të tjera, të cilat vlerësohen të arsyeshme dhe të argumentuara, sipas akteve juridike dhe përcaktimeve për teknologjinë e përpunimit të nënprodukteve të naftës, që janë në fuqi.

"Licenca e përpunimit" përgatitet në dy kopje, nga të cilat njërën e merr subjekti, ndërsa tjetra ruhet në arkivin e ministrisë, së bashku me të gjithë dokumentacionin e paraqitur nga subjekti aplikues.

10. Personi juridik i pajisur me "Licencën e përpunimit", që do të ndërtojë një impiant përpunimi, duhet të fillojë aplikimin për marrjen e Lejes Zhvillimore Komplekse sipas përcaktimeve të ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", dhe akteve nënligjore të nxjerra për zbatimin e tij, brenda një periudhe prej 1 viti nga data e miratimit të "Licencës së përpunimit" nga ministria. Me përfundimin e ndërtimit të impiantit sipas Lejes Zhvillimore Komplekse, subjekti duhet të pajiset me leje përdorimi në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".

Për vënien në funksionim të impiantit merret vërtetimi teknik për respektimin e normave dhe kushteve teknike, si dhe të kapaciteteve të depozitimit dhe/ose magazinimit të nënprodukteve të naftës, që do të prodhojë impianti i përpunimit, lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Përgjegjës, sipas kritereve të përcaktuara nga ministri.

11. Formulari-tip, kërkesa-tip dhe dokumenti e formati tip i "Licencës së përpunimit" për impiantet e përpunimit të nënprodukteve të naftës miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për hidrokarburet.

12. Në rast mosrespektimi të afateve dhe kërkesave ligjore të përcaktuara në pikën 10, të këtij vendimi, "Licenca e përpunimit" shfuqizohet.

13. Shoqëria e pajisur me "Licencën e përpunimit" ka detyrimin të njoftojë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike, ministrinë për çdo ndryshim, që i referohet dokumentacionit dhe kushteve të përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi, në bazë të të cilave është dhënë "Licenca e përpunimit".

14. Impiantet e përpunimit janë të detyruara të zbatojnë normat dhe kushtet teknike të projektit. Ndryshimet në skemën dhe kartën teknologjike të funksionimit të impianteve të përpunimit bëhen vetëm me miratimin e ministrisë.

15. Transferimi i "Licencës së përpunimit" bëhet vetëm pas miratimit të ministrisë, sipas rregullave të veçanta të miratuara nga ministri përgjegjës për hidrokarburet dhe me kusht që

personi juridik, tek i cili transferohet "Licenca e përpunimit", duhet të plotësojë aftësitë e nevojshme teknike dhe financiare, të përcaktuara në shkronjat "a", "b", "c", "f", "gj", "h", "j", "k", të pikës 2, të këtij vendimi.

16. Dhënia e "Licencës së përpunimit" të nënprodukteve e naftës bëhet kundrejt pagesës nga subjekti aplikues të tarifës prej 5 000 000 (pesë milionë) lekësh, ndërsa rinovimi i "Licencës së përpunimit" bëhet kundrejt pagesës së tarifës 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë.

Të ardhurat, që realizohen nga pagesat e këtyre tarifave, derdhen tërësisht në buxhetin e shtetit.

17. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 756, datë 12.11.2014

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2014, MIRATUAR PËR MINISTRINË E INTEGRIMIT EVROPIAN, PËR PËRBALLIMIN E TVSH-së, NË KUADËR TË PROJEKTIT "GREEN BOAT", FINANCUAR NGA BASHKIMI EVROPIAN NËPËRMJET FONDEVE IPA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe të neneve 10 e 13, të ligjit nr., 185/2013 "Për buxhetin e vitit 2014", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Integrimit Evropian, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Integrimit Evropian, në buxhetin e miratuar për vitin 2014, në programin "Mbështetje institucionale për procesin e integrimit", zëri "Shpenzime kapitale, kapitulli 04 (TVSH)" t'i shtohet kundërvlera në lekë e fondit prej 29 300 (njëzet e nëntë mijë e treqind) eurosh, për përballimin e kostos së TVSH-së për projektin "Green Boat", të financuar nga Bashkimi Evropian, nëpërmjet fondeve IPA, program i bashkëpunimit ndërkufitar Greqi-Shqipëri, me përfitues Komunën Pustec.

2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Kontigjencës, i miratuar në buxhetin e vitit 2014.

3. Ngarkohet Ministria e Integrimit Evropian për përgatitjen e dokumentacionit të akordimit dhe transferimit të shumës përkatëse Komunës Pustec, në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 757, datë 12.11.2014

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E KULTURËS, PËR TEATRIN KOMBËTAR TË OPERËS DHE BALETIT E ANSAMBLIN POPULLOR, TË OBJEKTEVE DHE TRUALLIT FUNKSIONAL, ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME 11 754.2 M^2, PJESË E PRONËS NR. 109, ME EMËRTIM "SHA RIPARIM ARTILERIE", ME VENDNDODHJE NË BRAR, TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, QË I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, shkronja "c", të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Kulturës, për Teatrin Kombëtar të Operës dhe Baletit e Ansamblin Popullor, të objekteve nr. 16,

17, 18 e 21 dhe truallit funksional, me sipërfaqe të përgjithshme 11 754.2 (njëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e katër pikë dy) m^2, pjesë e pronës nr. 109, me emërtim "Sh.a. Riparim Artilerie", me vendndodhje në Brar, Tiranë, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për t'u përdorur për magazinimin dhe përpunimin e dekoreve të shfaqjeve.

2. Sipërfaqja e përgjithshme prej 11 754.2 (njëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e katër pikë dy) m^2, e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

3. Ministrisë së Kulturës, Teatrit Kombëtar të Operës dhe Baletit e Ansamblit Popullor u ndalohet të ndryshojnë destinacionin e sipërfaqes së pronës, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojnë ose t'ua japin atë në përdorim të tretëve.

4. Vendimi nr. 634, datë 23.7.2010, i Këshillit të Ministrave, "Për kalimin në përdorim të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për Teatrin Kombëtar të Operës dhe Baletit e Ansamblin Popullor, të objektit nr. 19, "Godina e sinoptikës së vjetër", pjesë e pronës nr. 109, "Ish-Uzina e Artilerisë", në Brar, Tiranë, në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar me vendimin nr. 198, datë 16.3.2011, të Këshillit të Ministrave, shfuqizohet.

5. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, ministri i Kulturës, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Plan vendosja e prones nr.109 SHA Riparim Artilerie Brar,TIRANE.
(Sip. dhe objektet qe kerkohen per kalim nga Ministria e Mbrojtjes ne administrim te Ministrise se K

koordinatave shteterore



Shpjeguese prona109

Sip e pergjithshme = 43169.2 m2
Kufiri i repartit

Sip S3 = 11754.2 m2 (sip qe kerkohet per kalim ne administrim te Ministrise se Kultures "TKOBAP".)
Sip.e ndertimit = 4913.74m2(sip.e ndertimit e objekteve me nr. 16,17,18,21 (sip.e ndretimit qe kerkohet per kalim ne administrim te Ministrise se Kultures "TKOBAP".)

Sip S2 = 18179 m2 (sip.qe kerkohet per kalim ne administrim te
Sip.e ndertimit =3761.07 m2(sip.e ndertimit e objekteve me nr.6,7,8,10,11,12,14,15 qe kerkohen per kalim ne administrim te DF

Sip S1 = 13236.0 m2 sip.qe mbetet ne administrim te MM

Shenim-Kjo planvendosje u hartua sipas dokumentacionit teknik të marrë nga arkivi i I.GJ.U-s shkreses dhe skicës bashklidhur me nr.6357/3 dt.28-08-2014,të Sekretarit te Përgjith

unuar Shtator 2014.

) 404 950 405 150

Shkalla 1:2500

VENDIM
Nr. 758, datë 12.11.2014

PËR KALIMIN NË PRONËSI, PA SHPËRBLIM, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MISIONI I BAMIRËSISË "MOTRAT E NËNË TEREZËS", TË PRONËS NR. 1218, ME EMËRTIM "SPITALI DHE SHLU", ME VENDNDODHJE NË PUKË, SI DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3, pika 4, e 4, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, dhe të nenit 761 e neneve në vijim, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi, pa shpërblim, nga Ministria e Mbrojtjes te misioni i bamirësisë "Motrat e Nënë Terezës", të pronës së paluajtshme shtetërore nr. 1218, me emërtim "Spitali dhe SHLU", me vendndodhje në Pukë, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, sipas formularit standard të inventarizimit, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, për t'u përdorur nga misioni i bamirësisë "Motrat e Nënë Terezës", për banim dhe zhvillim të veprimtarisë së tyre në qytetin e Pukës.

2. Prona nr. 1218, me emërtim "Spitali dhe SHLU", me vendndodhje në Pukë, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

3. Misionit të bamirësisë "Motrat e Nënë Terezës", i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronës nr. 1218, me emërtim "Spitali dhe SHLU", me vendndodhje në Pukë, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe misioni i bamirësisë "Motrat e Nënë Terezës", për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

3. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Për inventarizimin e pronave si klasa të veçanta)

MINISTRIA E MBROJTJES
Bashkia Pukë
Fusha e përdorimit të pronës
Për Mbrojtjen Kombëtare

	A		B				C			
Nr.	Zona kadastrale, indeksi i hartës	Numri i pasurisë	Emërtesa e pronës vendndodhja/ shtrirja gjeografike	Komponentët përbërës të pronës	Adresa/ vendndodhja e komponentëve përbërës	Përmasat e pronës në m^2 ose MI	Funksioni për të cilin përdoren prona	Enti me përgjegjësi administrative	Enti përdorues Statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera, shënime të veçanta
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1218			Spitali dhe SHLU		PUKË	4301m^2	Për mbrojtjen	Ministria e Mbrojtjes Re. Usht. Nr. 7001 (BMR)	Reparti ushtarak Nr. 7010	-Identifikuar me të dhënat e formularit standard dhe të planvendosjes dërguar me shkresën e BMR .nr. 3566, datë 23.10.2012
			Objekti nr. 4 2 kate			307.05				
			TRUALL			**3993.95**				

VENDIM
Nr. 760, datë 12.11.2014

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 439, DATË 2.7.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË LEGALIZIMIT TË NDËRTIMEVE PA LEJE, SHTESAVE ANËSORE APO NË LARTËSI, TË NDËRTUARA NGA SHOQËRIA "HAWAI-ALB" SHPK"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 43/1, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas pikës 4, të vendimit nr. 439, datë 2.7.2014, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 4.1 me këtë përmbajtje:

"4/1. Kur trualli mbi të cilin është ngritur objekti bazë ose shtesa anësore/në lartësi, apo një pjesë e tij, rezultojnë në pronësi shtetërore, sipas regjistrit të pasurive të paluajtshme, kalimi i pronësisë mbi sipërfaqen përkatëse kryhet pa pagesë, në mbështetje të neneve 3, pika 4, e 4, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pasuritë e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, dhe të nenit 761, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 761, datë 12.11.2014

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 637, DATË 21.5.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR NDRYSHIMIN E TARIFAVE TË TRANSPORTIT QYTETAS TË UDHËTARËVE, TË MIRATUARA ME VENDIMIN NR. 146, DATË 26.2.1998, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 10, shkronja "c", e 14, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, "Për transportet rrugore", të ndryshuar, dhe të neneve 121, pika 1, e 124, pika 1, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 637, datë 21.5.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për ndryshimin e tarifave të transportit qytetas të udhëtarëve, të miratuara me vendimin nr. 146, datë 26.2.1998, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar".

2. Tarifat e miratuara me vendimin nr. 637, datë 21.5.2008, të Këshillit të Ministrave, do të vazhdojnë të zbatohen deri në çastin e miratimit të tarifave nga këshilli bashkiak përkatës, në përputhje me nenet 10 e 14, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, por jo më shumë se një muaj nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 762, datë 12.11.2014

PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE TË DHËNIES SË KUJDESIT PËR SHËNDETIN MENDOR PËR PERSONAT QË GJENDEN NË INSTITUCIONET REZIDENCIALE TË PËRKUJDESJES SOCIALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të paragrafit të dytë të nenit 18, të ligjit nr. 44/2012, "Për shëndetin mendor", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Personave që gjenden në institucionet rezidenciale të përkujdesjes sociale, me qëllim parandalimin apo trajtimin e çrregullimeve të shëndetit mendor, u ofrohet kujdes për shëndetin mendor nga të gjitha nivelet e ofrimit të këtij kujdesi, parashikuar në pikën 1, të nenit 10, të ligjit 44/2012, "Për shëndetin mendor".

2. Kujdesi i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, ofrohet sipas rregullave të përgjithshme të organizimit dhe të funksionimit të shërbimeve të shëndetit mendor në Republikën e Shqipërisë.

3. Personat që gjenden në institucionet rezidenciale të përkujdesjes sociale, në nivelin parësor të ofrimit të kujdesit për shëndetin mendor, mund të ndiqen nga mjeku i kontraktuar nga ky institucion, por, në çdo rast, çdo rezident duhet të regjistrohet në qendrën shëndetësore që mbulon territorin e lokalizimit të këtij institucioni.

4. Ngarkohen ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe Fondi i Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor të përcaktojnë ngarkesën për çdo mjek familjeje të qendrave shëndetësore, të parashikuara në pikën 3, të këtij vendimi.

5. Shërbimi i specializuar për shëndetin mendor, për personat në nevojë për këtë shërbim, do të ofrohet nga qendrat komunitare të shëndetit mendor dhe, në mungesë të këtyre të fundit, nga mjeku specialist psikiatër/ neuropsikiatër pranë poliklinikave në rrethet përkatëse.

6. Strukturat rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe strukturat lokale të shëndetit publik institucionalizojnë bashkëpunimin, përmes miratimit të planeve të përbashkëta të punës, për dhënien e shërbimit shëndetësor konform përcaktimeve të këtij vendimi.

7. Shërbimi psiko-social i institucioneve rezidenciale të përkujdesjes sociale bashkëpunon ngushtësisht me shërbimin psiko-social pranë strukturave lokale të shëndetit publik, pjesë të ekipeve multidisiplinare, pranë qendrave komunitare të shëndetit mendor.

8. Shërbimi i specializuar me shtretër, për shëndetin mendor, ofrohet vetëm me referim të qendrave komunitare të shëndetit mendor dhe, në mungesë të tyre, nga mjeku specialist psikiatër/neuropsikiatër i rrethit dhe vetëm atëherë kur janë shteruar të gjitha mundësitë e trajtimit ambulator/komunitar të pacientit, me qëllim shmangien e institucionalizmit të tij.

9. Personat me çrregullime të shëndetit mendor, të cilët kërkojnë vlerësimin e aftësisë për punë, do të paraqiten në komisionet mjekësore, të cilat do t'i rekomandojnë për dërgimin në Komisionin Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP), sipas legjislacionit në fuqi.

10. Ngarkohen ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe ministria përgjegjëse për politikat sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 763, datë 12.11.2014

PËR KUOTAT E PRANIMIT DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT, NË PROGRAMET E SPECIALIZIMEVE AFATGJATA, TË CIKLIT TË TRETË TË STUDIMEVE, NË FUSHËN E MJEKËSISË, PËR VITIN AKADEMIK 2014 - 2015

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, pika 1.3.2, 34, pika 4, 35 e 75, të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuotat e pranimit në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për programet e specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë të studimeve, me kohë të plotë, për vitin akademik 2014-2015, janë 365, të ndara si më poshtë vijon:

a) Kuota për kandidatët brenda territorit të vendit 340;
b) Kuota për kandidatët me kombësi shqiptare nga trojet jashtë kufijve të vendit 20;
c) Kuota për transferime 5.

2. Kuotat e pranimit për kandidatët brenda territorit të vendit, të parashikuara në shkronjën "a", të pikës 1, të këtij vendimi, ndahen si më poshtë vijon:

a) Kuota të mbuluara nga Ministria e Shëndetësisë 185;
b) Kuota të mbuluara nga Ministria e Drejtësisë 14;
c) Kuota të mbuluara nga Ministria e Mbrojtjes 15;

ç) Kuota të pambuluara nga Ministria e Punëve të Brendshme 1;
d) Kuota të pambuluara 125.

3. Kuotat e pranimit për programet e specializimeve afatgjata të ciklit të tretë të studimeve me kohë të plotë, të përcaktuara në shkronjën "a", të pikës 1, të këtij vendimi, të ndara sipas programeve të studimit, pasqyrohen në tabelën nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Kuotat e pranimit për programet e specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë të studimeve me kohë të plotë, të përcaktuara në shkronjën "b", të pikës 1, të këtij vendimi, ndahen ndërmjet kandidatëve shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit, Kosovë, Maqedoni, Mali i Zi, Preshevë, Bujanovc dhe Medvegjë, sipas programeve të studimit, të pasqyruara në tabelën nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi. Këto kuota rishpërndahen me urdhër të ministrit të Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë.

5. Kandidatët nga Republika e Kosovës, Republika e Maqedonisë, Republika e Malit të Zi dhe nga prefekturat e Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjës, aplikojnë direkt në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, dhe u nënshtrohen të njëjtave procedura konkurrimi, si dhe kandidatët shqiptarë brenda territorit të vendit. Pranimi i tyre në programin përkatës të studimit bëhet bazuar në kriterin e meritës, duke respektuar kuotat për këtë kategori kandidatësh.

6. Kuotat e pranimeve për transferim studimesh, të përcaktuara në shkronjën "c", të pikës 1, të këtij vendimi, shpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, mbështetur edhe në kërkesën e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë. Studenti transferohet nga programe specializuese afatgjata të akredituara, të ofruara nga institucione të akredituara dhe të licencuara në vendin përkatës, në programe të njëjta ose të ngjashme specializimi afatgjata, deri në vitin e dytë të programit përkatës specializues.

7. Aplikojnë për programe studimi specializuese afatgjata të gjithë kandidatët që kanë fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve në rregulloren përkatëse të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë.

8. Pranimet e studentëve në programin specializues afatgjatë, në numrin përkatës të kuotës së përcaktuar në këtë vendim, bëhen sipas përcaktimeve në udhëzimin përkatës të ministrit të Arsimit dhe Sportit, rregullores së specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, të miratuar nga ministri i Shëndetësisë dhe ministri i Arsimit dhe Sportit, si dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

9. Kuotat e paplotësuara rishpërndahen me urdhër të ministrit të Arsimit dhe Sportit.

10. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët që ndjekin programet specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë, sipas përcaktimeve të këtij vendimi, është 115,000 (njëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë. Studentët e shpallur fitues paguajnë/arkëtojnë, menjëherë, në llogarinë e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, 30% të tarifës vjetore të shkollimit. Këstet e tjera arkëtohen sipas rregullores së miratuar nga Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.

11. Studenti, i cilësuar në bazë të rregullores së institucionit të arsimit të lartë publik si përsëritës, i nënshtrohet tarifës së plotë vjetore të shkollimit të vitit akademik në të cilin vazhdon studimet.

12. Fakulteti që mbulon programin specializues afatgjatë siguron studentët për përgjegjësinë profesionale ndaj palëve të treta dhe për shëndetin e tyre, sipas përcaktimeve në rregulloren përkatëse të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, përpara fillimit të programit specializues dhe në vijim, në çdo fillim viti akademik, duke nisur nga data e skadencës së policës së lidhur një vit më parë.

13. Studentët që përfitojnë nga kuotat e parashikuara në shkronjat "a", "b", "c" dhe "ç", të pikës 2, të këtij vendimi, lidhin kontrata, përkatësisht me Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Mbrojtjes dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme, ku përcaktohen detyrimet mes palëve, si dhe penalitetet, në rastet e mosrespektimit të tyre. Modeli i kontratës dhe modalitetet e lidhjes së saj përcaktohen me urdhër të ministrit që mbulon fushën përkatëse dhe i bëhen të ditura kandidatit para hapjes së procesit të aplikimeve.

14. Kandidatët që përfitojnë nga kuotat e parashikuara në shkronjat "b", "c" dhe "ç", të pikës 2, të këtij vendimi, duhet të paraqesin, në momentin e aplikimit, një shkresë mbështetëse nga ministria përkatëse.

15. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, pa efekte buxhetore shtesë.

16. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

TABELA Nr. 1

KUOTAT E PRANIMIT DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT, NË PROGRAMET E CIKLIT TË TRETË TË STUDIMEVE SPECIALIZUESE AFATGJATA, NË FUSHËN E MJEKËSISË, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË, PËR VITIN AKADEMIK 2014 - 2015

EMERTIMI I UNIVERSITETIT	ID_PROGRAMIT	EMERTIMI I PROGRAMIT	Ministria e Shëndetësisë	Ministria e Mbrojtjes	Ministria e Drejtësisë	Ministria e Punëve të Brendshme	Kuota për kandidatë nga Trojet	Kuota të pambuluara	Gjithsej
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	1	Alergologji	3	-	-	-	-	2	5
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	2	Anatomi Patologji	4	-	-	-	-	2	6
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	3	Anestezi reanimacion	12	3	-	-	1	2	18
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	4	Dermatologji	3	-	-	-	-	2	5
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	5	Endokrinologji	4	-	-	-	1	3	8
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	6	Gastrohepatologji	4	-	1	-	-	2	7
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	7	Hematologji	3	-	1	-	1	1	6
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	8	Diagnozë me imazhe	8	-	-	-	1	3	12
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	9	Kardiokirurgji	2	-	-	-	1	2	5
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	10	Kardiologji	12	-	-	-	1	5	18
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	11	Kirurgji e përgjithshme	12	1	-	-	1	2	16
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	12	Kirurgji maxilo-faciale	3	2	-	-	1	6	12
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	13	Laborator klinik-biokimik	6	-	-	1	-	4	11
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	14	Mikrobiologji	6	-	-	-	-	4	10
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	15	Mjek familje	-	-	-	-	-	20	20
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	16	Mjekësi interne	9	1	-	-	1	-	11
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	17	Mjekësi ligjore	-	-	5	-	1	7	13
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	18	Nefrologji	4	-	-	-	1	3	8
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	19	Neurologji	5	-	1	-	1	2	9
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	20	Neurokirurgji	2	-	-	-	1	2	5
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	21	ORL	5	1	-	-	1	2	9
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	22	Obstetrikë gjinekologji	10	-	-	-	1	7	18
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	23	Okulistikë	5	1	-	-	1	2	9
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	24	Onkologji	5	-	1	-	1	2	9
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	25	Ortopedi traumatologji	6	3	-	-	1	3	13
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	26	Pediatri	12	-	-	-	-	-	12
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	27	Pneumologji	4	-	1	-	-	3	8
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	28	Psikiatri	4	1	3	-	1	2	11
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	29	Psikiatri e fëmijëve	1	-	-	-	-	4	5
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	30	Rheumatologji	4	-	1	-	-	4	9
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	31	Sëmundje infektive	5	-	-	-	-	5	10
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	32	Shëndet publik	-	-	-	-	-	10	10
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	33	Pedodonti	-	-	-	-	-	5	5
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	34	Toksikologji klinike	5	-	-	-	1	2	8
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	35	Mjekësi urgjence	12	2	-	-	-	-	14
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	36	Mjekësi transfuzive	5	-	-	-	-	-	5
		TOTALI	**185**	**15**	**14**	**1**	**20**	**125**	**360**

VENDIM
Nr. 764, datë 12.11.2014

PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË SHËRBIMEVE NË QENDRAT SPITALORE UNIVERSITARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 12, të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shërbimi në qendrat spitalore universitare realizon funksione diagnostikuese e trajtuese themelore, në nivel të lartë shkencor, si pjesë e spitalit universitar, si dhe funksione mësimore e kërkimore, si pjesë e institucionit të arsimit të lartë.

2. Bordi i qendrës spitalore universitare përcakton numrin e përgjithshëm të shërbimeve dhe llojin e shërbimeve unikale të qendrës spitalore universitare.

3. Shërbimi në qendrat spitalore universitare ka në përbërje të tij, të paktën, dy anëtarë efektivë si personel akademik për secilin specialitet, njëri prej të cilëve duhet të jetë, të paktën, me gradë shkencore "Doktor".

4. Specialitetet me regjim të zakonshëm duhet të kenë shfrytëzim shtrati jo më pak se 85%, ndërsa specialitetet me regjim ditor duhet të kenë xhiro shtrati jo më pak se 85%. Shërbimi detyrohet, që, brenda katër viteve nga miratimi i këtij vendimi, të përmbushë këta tregues. Bordi miraton treguesit specifikë të organizimit të çdo shërbimi në qendrat spitalore universitare.

5. Numri i personelit mjekësor, që shërben në specialitetet e shërbimeve të ndryshme në qendrat spitalore universitare, miratohet çdo vit nga bordi i qendrës spitalore universitare.

6. Vendimi nr. 771, datë 7.11.2012, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kritereve për përcaktimin e numrit të personelit dhe kapaciteteve të njësisë së shërbimit në qendrat spitalore universitare", shfuqizohet.

7. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 765, datë 12.11.2014

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 46, DATË 29.1.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KRIJIMIN DHE MËNYRËN E ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE DHE UJËRAVE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 11 e 51, pikat 2 e 3, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 8, e kreut III, "Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të ISHMPU-së", të vendimit nr. 46, datë 29.1.2014, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

"8. Komisioni i ankimit ka në përbërjen e tij:
- Drejtorin e Inspektimit të Mjedisit;
- Drejtorin e Inspektimit të Pyjeve;
- Drejtorin e Inspektimit të Ujërave;
- Juristin e institucionit.

8.1 Komisioni mblidhet për shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit ndaj të cilit është bërë ankim/kërkesë administrativ/e dhe merr vendim, në përputhje me procedurat dhe afatet e përcaktuara në ligjin nr. 10433, datë 16.6.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", dhe në ligjin nr. 10279, datë 20.5.2010, "Për kundërvajtjet administrative".

8.2 Në të gjitha rastet kur komisioni vlerëson pranimin e ankesës/kërkesës për shfuqizimin e vendimit administrativ, autoriteti përkatës, i cili ka marrë vendimin, me kërkesë të komisionit, duhet të jetë i pranishëm në mbledhjen e komisionit.

8.3 Për çdo vendim, komisioni njofton me shkrim zyrtarisht subjektin ankues/kërkues.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 766, datë 12.11.2014

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2014, MIRATUAR PËR GJYKATËN KUSHTETUESE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 185/2013, datë 28.12.2013, "Për buxhetin e vitit 2014", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Gjykatës Kushtetuese, në buxhetin e miratuar për vitin 2014, në zërin "Shpenzime kapitale", t'i shtohet fondi 2 000 000 (dy milionë) lekë.

2. Efekti financiar i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi i kontingjencës.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Gjykata Kushtetuese për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 767, datë 12.11.2014

PËR SHPALLJEN "QENDËR HISTORIKE" TË NJË ZONE NË QYTETIN-MUZE TË BERATIT DHE MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR MBROJTJEN, KONSERVIMIN E INTEGRUAR, ADMINISTRIMIN E "QENDRËS HISTORIKE" DHE ZONËS SË MBROJTUR TË QYTETIT TË BERATIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 3 e 4, të nenit 29, të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen "Qendër Historike" në qytetin-muze të Beratit të zonës, sipas hartës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Miratimin e rregullores "Për mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e "Qendrës Historike" dhe zonës së mbrojtur të qytetit të Beratit", e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Vendimi nr. 826, datë 28.12.2005, i Këshillit të Ministrave, "Për shpalljen e "Qendrës Historike" të një zonë në qytetin muze të Beratit dhe miratimin e rregullores së administrimit të kësaj qendre", shfuqizohet.

4. Ngarkohen Ministria e Kulturës dhe bashkia e Beratit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama


ZONIFIKIMI I QENDRËS HISTORIKE DHE ZONËS SË MBROJTUR TË QYTETIT BERAT
LEGJENDA
MIRATOHET:
KRYEMINISTRI
EDI RAMA
MINISTRIA E KULTURËS
MINISTRI
MIRELA KUMBARO FURXHI
INSTITUTI I MONUMENTEVE TE KULTURËS "GANI STRAZIMIRI"
DREJTORI
ARTA DOLLANI
VENDIM Nr__ DATE____2014
VERI
0
100
500 m

RREGULLORE
E MBROJTJES, KONSERVIMIT TË INTEGRUAR DHE ADMINISTRIMIT TË QENDRËS HISTORIKE DHE ZONËS SË MBROJTUR TË QYTETIT TË BERATIT

Neni 1
Qëllimi dhe objektivat

Kjo rregullore përcakton detyrimet dhe mënyrat për mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e vlerave historiko - kulturore të Qendrës historike dhe Zonës së mbrojtur të qytetit të Beratit.

Për vlerat e rëndësishme historiko- kulturore, Berati tradicional, me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 172, datë 2.6.1961, është shpallur "qytet-muze" dhe vënë në mbrojtje shtetërore. Për vlerat e pakrahasueshme universale, qendrat historike të qytetit të Beratit dhe të Gjirokastrës janë shpallur "Pasuri botërore" në Seri në vitin 2008 si shembuj të rrallë të arkitekturës tipike të periudhës osmane.

Objektivat kryesorë të kësaj rregulloreje janë:

1. Administrimi i qendrës historike dhe zonës së mbrojtur të qytetit-muze të Beratit sipas hartës së zonifikimit, që i bashkëngjitet kësaj rregulloreje si pjesë integrale e saj.
2. Mbrojtja, konservimi dhe restaurimi i vlerave historiko-kulturore të qendrës historike të qytetit-muze të Beratit.
3. Mënyrat e bashkëpunimit me njësitë e qeverisjes vendore të qytetit të Beratit për administrimin, mbrojtjen dhe restaurimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të qendrës historike të qytetit-muze të Beratit.

Neni 2
Struktura e hapësirës urbane në mbrojtje

Hapësira urbane në mbrojtje e qytetit të Beratit, për vlerat e saj historiko-kulturore, dhe si pjesë e trashëgimisë kulturore i nënshtrohet ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar me ligjin nr. 9882 datë 28.2.2008 dhe ligjit nr. 9386, datë 4.5.2005 "Për muzetë".

Hapësira urbane në mbrojtje e qytetit të Beratit përbëhet nga:

1. Qendra historike;
2. Zona e mbrojtur.

Plani i përgjithshëm vendor i qytetit të Beratit duhet të marrë parasysh kufijtë dhe kriteret e mbrojtjes të qendrës historike dhe zonës së mbrojtur.

Neni 3
Qendra historike dhe kufijtë e saj

Qendra historike është pjesa me vlera urbanistik-arkitektonike e qytetit të Beratit. Ajo ruan gjini të ndryshme ndërtimore të periudhave prej shekullit IV p.e.s. dhe deri më sot, në shkallë të ndryshme autenticiteti. Këto ndërtime janë të lidhura me mjedisin tradicional, i cili është pjesë e qendrës historike. Qendra historike përmbledh brenda kufijve të saj:

Lagjen Kala, lagjen Mangalem, lagjen Goricë, si dhe Qendrën Mesjetare Islamike.

Kufijtë e saj janë: Lapidari në qafën e kalasë, ndjek rrugën e vjetër që zbret në qendër të Beratit, duke e përfshirë atë në të dy krahët, kthehet te Qendra Islamike me xhaminë Mbret, Teqenë Helvetive dhe Konakët e Teqesë. Këtu përfshihen të gjitha mjediset dytësore dhe portat e banesave që rrethojnë Qendrën Islamike, del te cepi i markatës dhe në rrugën kryesore. Nga këtu merr rrugën drejt Mangalemit, pas Pallatit të Kulturës duke e përfshirë dhe rrugën, dhe del para xhamisë së Beqarëve dhe kalon drejt, del matanë lumit në Goricë. Lagjja Goricë përfshihet me gjithë kurorën e gjelbër deri në izoipsin 200 m, zbret në drejtim të urës së Goricës, del në rrugën kryesore duke u ngjitur përbri memorialit të Skënderbeut, ngjitet deri në izoipsin 150 m mbi banesat e lagjes Muzaka, duke pasur brenda dhe kurorën e gjelbër poshtë mureve të kalasë dhe bashkohet te lapidari në qafën e kalasë.

Kufijtë e qendrës historike janë kufijtë e shpallur "Pasuri botërore", paraqiten në hartën e zonifikimit të qytetit të Beratit e cila është pjesë kësaj rregulloreje.

Neni 4
Ndërhyrjet e lejuara në qendrën historike

Në qendrën historike nuk lejohen ndërtimet e reja. Me qëllim ruajtjen e vlerave urbanistiko - arkitekturore të qendrës historike brenda kësaj zone lejohen vetëm këto ndërhyrje:

1. Ndërhyrje sistematike konservuese, restauruese dhe të mirëmbajtjes sipas parimeve të konservimit të integruar.

2. Ruajtja dhe përfshirja e vlerave mjedisore duke mbajtur të pandryshuar konfiguracionin e truallit dhe llojshmërinë e drurëve dhe bimësisë tradicionale.

3. Konservimi i rrënojave të ndërtimeve me konture të qarta murature, në hapësirën e qendrës historike, për të penguar degradimin e mëtejshëm të tyre. Kur rrënojat ruhen në lartësi mbi 3m dhe cenojnë dukshëm njësinë e ansambleve, brenda të cilëve përfshihen, mund të kryhet rikonstruksioni në të njëjtin volum, mbi strukturën ekzistuese (mureve perimetral) bazuar në dokumentacionin e qartë fotografik, grafik, mbështetur në tipologjinë, trajtimin arkitektonik dhe teknikën tradicionale në pjesët e dukshme.

4. Në raste fatkeqësish natyrore, të shembjeve ose djegies së objekteve me vlera të trashëgimisë kulturore, rikonstruksioni mund të kryhet mbi strukturat ekzistuese, sipas formulimit kompozicional dhe arkitektonik të gjendjes para rrënimit, bazuar në dokumentacionin e qartë fotografik, grafik etj.

5. Objektet pa status brenda ansambleve arkitektonike të qendrës historike, ndërtuar në vitet 1950 – 1990, të cilat me volumet dhe formulimin e tyre arkitektonik, dëmtojnë vlerat dhe unitetin kompozicional të qendrës historike, nëpërmjet studimesh rehabilitimi mund të parashikohen përshtatje në harmoni me ansamblin arkitektonik ku bëjnë pjesë.

6. Ndërtimet pa leje brenda qendrës historike evidentohen nga ana e Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare Berat, nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm. Nga ana e DRKK-së Berat, në bashkëpunim me Institutin e Monumenteve të Kulturës, hartohet plan veprimi për trajtimin e ndërtimeve të paligjshme, i cili miratohet në KKR. Vendimi për trajtimin e tyre merret në përputhje me plan veprimin dhe miratohet nga ana e KKR-së.

7. Ndalohen ndërtimet e reja në qendrën historike me përjashtim të rikonstruksionit të rrjetit inxhinierik nëntokësor dhe rikonstruksioneve të përmendura në pikat më sipër.

Neni 5

Zona e mbrojtur dhe kufijtë e saj

Zona e mbrojtur shtrihet përreth qendrës historike. Ajo me vlerën e saj historiko-kulturore, plotëson edhe pasuron vlerat e qendrës historike. Zona e mbrojtur ruhet në përbërësit urbanistikë, arkitekturorë dhe mjedisorë.

Kufijtë e zonës së mbrojtur përfshijnë: majën e kodrës në kalanë e Biftës duke kaluar në izoipsin 200 m, zbret drejt Lagjes së Bregut ku lë brenda zonës gjithë faqen që duket nga qendra e Beratit, me pronësitë 9/48, 9/47, 9/46, 9/45, 9/40, 9/32, 9/25, ku kalon në rrugën 9/20 duke lënë brenda zonës pronësitë 10/59, 10/60, 10/61, ndjek rrugën 10/58, 10/27, lë brenda pronësitë 10/29, 10/52, 10/ 1003, 26/59, 26/61, 26/56, 26/44, 26/39, 27/9 ndjek rrugën 27/6, lë brenda ½, ¼, 1/10, 1/21, 1/14, 2.47, 2/17, del në rrugën 2/36, ndjek rrugën 2/50, duke përfshirë kodrën e Shën Thanasit ku përfshihet maja e saj me izoipsin 150 m, zbret në rrugicat 3/129, 3/124, 3/120, ndjek rrugën 5/152, që të nxjerrin te burimi në rrugën kryesore 15/4, mban stadiumin e vjetër brenda saj, mban rrugën 14/75 dhe pronën 13/8, kalon lumin dhe ngjitet drejt kurorës së gjelbër në Goricë në izoipsin 275 m, përfshin rrënojat e kalasë së Goricës dhe zbret poshtë urës së Goricës duke përfshirë godinën e shekullit të 20-të, 14/124 së bashku me ish-mullirin pranë urës, ngjitet në rrugën perëndimore të kalasë mbi lagjen "Muzaka" dhe bashkohet te kodra e Biftës.

Kufijtë e zonës së mbrojtur janë kufijtë e shpallur "Pasuri botërore".

Zona e mbrojtur për veçoritë e ndryshme që ka në të gjithë hapësirën e saj ndahet në katër nën zona sipas hartës bashkëngjitur:

- Nënzona I (veriperëndimore);
- Nënzona II (jugore);
- Nënzona III (lindore fushore);
- Nënzona IV (lindore kodrinore);
- Kufijtë e zonës së mbrojtur dhe kufijtë e nënzonave paraqiten në hartën e zonifikimit të qytetit të Beratit e cila është pjesë kësaj rregulloreje.

Neni 6

Ndërhyrjet e lejuara në zonën e mbrojtur

Nënzonat brenda zonës së mbrojtur do t'u nënshtrohen masave të ndryshme mbrojtëse specifike për secilën, duke u bazuar në karakteristikat e secilës.

Zona I (veriperëndimore)

Kjo zonë me terrenin e pjerrët që e karakterizon ka qenë dhe mbetet një zonë

tërësisht e pandërtuar dhe historikisht pjesë e zonës që mbron Kalanë. Në këtë zonë nuk lejohen ndërtimet e reja, pasi ndërtimi në këtë zonë mund të shkaktojë një dëmtim të pamjes të gjithë kompleksit të qendrës historike. Në këtë zonë kryhen studime për rregullimin e zonës së gjelbër dhe përmirësimin e imazhit të zonës.

Zona II (jugore)

Kjo zonë përfshin kurorën e gjelbër mbi lagjen Goricë ku ndodhen dhe rrënojat e kalasë së Goricës dhe shtratin e lumit Osum. Në këtë zonë ruhen vlerat mjedisore dhe arkeologjike duke mbajtur të pandryshuar konfiguracionin e truallit dhe llojshmërinë e drurëve e bimësisë tradicionale. Në këtë zonë nuk lejohet asnjë lloj ndërtimi i ri.

Zona III (lindore fushore)

Në këtë zonë përfshihet qendra urbane e qytetit. Për vetë terrenin fushor në të cilin shtrihet, kjo zonë paraqet një rëndësi të veçantë për mbrojtjen e qendrës historike. Ndërhyrjet e lejuara në këtë zonë janë:

1. Ruajtja e hapësirave të gjelbra ekzistuese, si dhe raportit ekzistues sipërfaqe e ndërtuar dhe zonë e gjelbër, e cila lejon fushëpamjen e qendrës historike nga qyteti.

2. Ndërtesat që kanë statusin "Monument" brenda kësaj zone iu nënshtrohen vetëm ndërhyrjeve konservuese restauruese.

3. Në këtë zonë mund të bëhen ndërtime të reja ose rikonstruksione të ndërtesave ekzistuese. Ndërtimet duhet t'u përmbahen disa specifikimeve për të mbrojtur pamjen dhe profilin e qytetit:

- Lartësia maksimale e lejuar për ndërtimet në këtë zonë është 5 kate, jo më tepër se 17 m deri në kornizën e çatisë.

- Nuk lejohen ndërtime me forma gjeometrike komplekse duke qenë se janë në kontrast me traditën ndërtimore lokale.

- Nuk lejohet ndërtimi i objekteve me karakter industrial.

- Nuk lejohen mbulimet e ndërtesave me çati me ngjyra të tjera ose me mbulesa të ndryshme nga forma tradicionale që janë lehtësisht të dallueshme brenda zonës.

- Ngjyrat e përdorura do të jenë në përputhje me ndërtimet tradicionale.

Zona IV (lindore kodrinore)

Kjo zonë ndodhet në lindje të qendrës historike dhe në veri të qendrës së qytetit. Pjesa kodrinore në këtë zonë që nga periudha osmane ka qenë me ndërtesa 2-3 kate me oborr. Ndërhyrjet e lejuara brenda kësaj zone janë:

1. Ndërtesat që kanë statusin "Monument" brenda kësaj zone i nënshtrohen vetëm ndërhyrjeve konservuese restauruese.

2. Lejohet të bëhen ndërtime të reja ose rikonstruksione të ndërtesave ekzistuese. Këto ndërtime do të kenë kufizime në lartësi, vëllim, formë, material dhe ngjyrë:

- Lartësia maksimale e lejuar për ndërtimet në këtë zonë është 3 kate, jo më tepër se 11 m deri në kornizën e çatisë.

- Në kompozimin arkitektonik të ndërtesave duhet të përdoren elementë morfologjikë të arkitekturës tradicionale.

- Nuk lejohen ndërtime me forma gjeometrike komplekse duke qenë se janë në kontrast me traditën ndërtimore lokale.

- Nuk lejohet ndërtimi i objekteve me karakter industrial.

- Ndërtesat e reja me destinacion banim të kenë lartësi 2-3 kate dhe duhet të mbulohen me çati 4-ujëse, sipas tipologjisë tradicionale.

- Nuk lejohen mbulimet e ndërtesave me çati me ngjyra të tjera ose me mbulesa të ndryshme nga forma tradicionale që janë lehtësisht të dallueshme brenda zonës.

- Ndërtesat e radhës së parë në rrugën nacionale, në të dy anët e saj , duke filluar nga Markata e deri në fund të kufirit të zonës së mbrojtur do të kenë karakteristikat e nënzonës III.

- Për ndërtimet në këtë zonë suvatimi i jashtëm është i detyrueshëm.

- Ngjyrat e përdorura do të jenë në përputhje me ndërtimet tradicionale.

Neni 7

Rrugët dhe sheshet

Rrugët dhe sheshet e qendrës historike dhe zonës së mbrojtur ruhen në formulimin kompozicional si pjesë organike e këtyre zonave.

Në qendrën historike:

Lejohen ndërhyrje për përmirësimin e infrastrukturës mbi dhe nëntokësore, projekti i të cilave miratohet në KKR.

Ndërhyrjet e rikonstruksionit në rrjetin rrugor dhe sheshe ruajnë detyrimisht materialet dhe teknikat tradicionale. Drurët dhe gjelbërimi tradicional në këtë zonë ruhen dhe pas degradimit ripërtërihen me të njëjtat lloje.

Në zonën e mbrojtur:

Lejohet rikonstruksioni i rrjetit rrugor dhe shesheve, duke përdorur materiale tradicionale.

Neni 8

Klasifikimi i objekteve brenda qendrës historike

Objektet brenda qendrës historike klasifikohen si më poshtë:

a) Monumente të kulturës të kategorisë së parë;

b) Monumente të kulturës së kategorisë së dytë;

c) Objektet pa status pjesë e ansambleve arkitektonike të qendrës historike.

Neni 9

Monumentet e kategorisë së parë

Monumentet e kategorisë së parë janë ndërtimet me vlera të rëndësishme tipologjike dhe arkitektonike. Monumentet e kategorisë së parë, me shkallë të mirë autenticiteti, ruhen në përbërësit kompozicionalë, arkitekturorë, teknikë dhe të materialeve të ndërtimit. Oborri, muret rrethuese porta e jashtme dhe ndërtimet ndihmëse, janë pjesë organike e monumentit dhe si të tillë i nënshtrohen të njëjtit trajtim.

Monumentet e kategorisë së parë ruhen në qendrën historike, në zonën e mbrojtur dhe në pjesën tjetër të qytetit.

Në monumentet e kategorisë së parë kompozimi i vëllimeve, trajtimi arkitektonik i pamjeve të jashtme dhe të brendshme, si dhe zgjidhja planimetrike dhe funksionale, nuk mund të ndryshohet, me përjashtim të vendosjes së nyjës higjieno-sanitare kur është e domosdoshme dhe nuk cenon vlerat për të cilat është vënë në mbrojtje.

Deri në shpalljen e zonës së mbrojtur të monumenteve të kategorisë së parë, nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, në përputhje me nenin 32 të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore" i ndryshuar, për aq sa nuk bie në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje, nuk lejohen ndërtime të reja në distancë jo më pak se 50 m larg nga mureve rrethuese nëse ka apo nga muret e objektit.

Trajtimi i objekteve ekzistuese brenda kësaj rrezeje, të shqyrtohet në KKR rast pas rasti.

Neni 10

Monumente të kategorisë dytë

Monumentet e kategorisë së dytë janë ndërtimet me vlera historiko- kulturore, kryesisht si bashkëformuese ansamblesh urbanistiko-arkitekturore, por edhe si vepra të veçanta.

Monumentet e kategorisë së dytë ruhen në volumet e tyre dhe trajtimin e tyre arkitekturor të pamjes së jashtme, duke përfshirë materialet dhe teknikat tradicionale. Kur brenda këtyre monumenteve, sidomos në objektet e banimit, ruhen ambiente karakteristike, si dhe gdhendje në dru, punime në allçi, dekorime pikturale ose mobilie arkitektonike me vlerë, këto ruhen në vendin ku janë.

Në brendësi të monumenteve të kategorisë së dytë lejohen ndryshime të strukturës kompozicionale dhe përdorimin e teknikave bashkëkohore, pa cenuar formulimin e pamjes së jashtme.

Neni 11

Objektet pa status pjesë e ansambleve arkitektonike të qendrës historike

Objektet pa status pjesë e ansambleve arkitektonike të qendrës historike, janë objekte të ndërtuara në vitet 50-90 brenda ansambleve arkitektonike të lagjeve Mangalem, Goricë, Kala, që me volumet dhe formulimin e tyre arkitekturor, nuk janë në harmoni me unitetin kompozicional të këtyre ansambleve.

Neni 12

Studimi, projektimi dhe zbatimi i punimeve në qendrën historike dhe monumente të veçanta

1. Projektet e restaurimit dhe restaurimi i monumenteve të kulturës bëhen nga institucione shtetërore të specializuara dhe nga subjekte të licencuara për këtë qëllim.

Projektet shqyrtohen në këshillin shkencor të IMK-së dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit (KKR).

2. Zbatimi i punimeve të mësipërme kryhet prej DRKK-ve ose prej subjekteve të licencuara për restaurim, nën mbikëqyrjen e supervizorit dhe kolaudatorit, caktuar prej IMK-së. Për

monumentet e kulturës pronë private, pjesa e shpenzimeve që i takon pronarit dhe mënyra e shlyerjes së tyre, bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

- Studimet dhe projektet e rikonstruksioneve të përmendura në pikat 3, 4 dhe 5 të nenit 4 hartohen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës (IMK), Drejtoria Rajonale të Kulturës Kombëtare (DRKK - Berat) ose nga persona të licencuar në fushën e restaurimeve për këtë kategori projektesh. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të IMK-së dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit (KKR). Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit për planifikimin e territorit.

- Studimet dhe projektet për ndërhyrje në rrjetin rrugor, infrastrukturën nëntokësore dhe rrjetin inxhinierik hartohen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës (IMK), Drejtoria Rajonale të Kulturës Kombëtare (DRKK), Berat, në bashkëpunim me Bashkinë e Beratit ose nga persona të licencuar në fushën restaurimeve dhe në kategoritë përkatëse të punimeve. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të IMK-së dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit (KKR). Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit për planifikimin e territorit.

Neni 13

Studimi, projektimi dhe zbatimi i punimeve në zonën e mbrojtur

1. Studimet për rehabilitimin e imazhit të zonës së mbrojtur hartohen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës (IMK), Drejtoria Rajonale të Kulturës Kombëtare (DRKK) në bashkëpunim me Bashkinë Berat, ose subjekte të licencuar në fushën e restaurimeve sipas rregullores së miratuar. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të IMK-së dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit (KKR). Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit për planifikimin e territorit.

2. Projektet e rikonstruksionit të ndërtesave në këtë zonë hartohen nga projektues ose subjekte projektuese të licencuar në projektim për kategorinë e mësipërme për fushën e ndërtimit. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të IMK-së dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit (KKR). Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit për planifikimin e territorit.

3. Zbatimi i punimeve të rikonstruksionit kryhet prej subjekteve ndërtimore që janë të licencuar për këtë kategori.

4. Projektet për ndërtimet e reja në këtë zonë, hartohen nga projektues ose subjekte projektuese të licencuar në projektim për fushën e ndërtimit. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të IMK-së dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit (KKR). Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit për planifikimin e territorit.

5. Projektet e rikonstruksionit të rrugëve, shesheve dhe infrastrukturës së tyre të përmendura në nenin 7 hartohen nga projektues ose subjekte projektuese të licencuar në projektim për kategorinë përkatëse në fushën e ndërtimit. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të IMK-së dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit (KKR). Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit për planifikimin e territorit.

Neni 14

Shfrytëzimi i monumenteve

Monumentet e kulturës shfrytëzohen, sipas rastit, për funksionet për të cilat janë ndërtuar, apo për funksione të tjera me kusht që këto funksione të mos dëmtojnë vlerat për të cilat monumenti është vënë në mbrojtje. Shfrytëzimi i monumenteve të kulturës, për funksione të ndryshme prej atyre për të cilat janë ngritur, bëhet vetëm pasi të jetë marrë miratimi i Këshillit Kombëtar të Restaurimeve.

Neni 15

Vendosja e elementëve dekorues dhe reklamave

Në monumentin e kategorisë së parë dhe të dytë nuk lejohet vendosja në mënyrë të ekspozuar e elementeve të cilat prishin pamjen dhe pengojnë fotografimin, filmimin dhe soditjen normale.

Nuk lejohet vendosja e xhamave me ngjyrë tjetër përveç llojit tradicional.

Vendosja e materialeve publicitare në objektet monument kulture bëhet në raste të veçanta festive-kulturore dhe ka karakter të përkohshëm.

Veprimtaritë kulturore në objektet monument kulture bëhet vetëm në rastet kur ato nuk rrezikojnë ose cenojnë vlerat e tyre.

Ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, jep lejen për organizimin e veprimtarive kulturore dhe vendosjen e materialeve publicitare.

Neni 16
Lëvizja e automjeteve

Brenda qendrës historike, në rrugët e ngushta, kalldrëme apo në monumente të rëndësishme etj, ndalohet kalimi i mjeteve të rënda, mbi 4 tonë, përveç rasteve të emergjencës, si dhe në rastin e forcave madhore. Në Urën e Goricës ndalohet kategorikisht kalimi i automjeteve.

DRKK-ja Berat, në bashkëpunim me Bashkinë Berat, hartojnë dhe përcaktojnë planin për mënyrat e lëvizjes dhe parkimit të automjeteve në hyrje të Qendrës historike.

Neni 17
Masat për mbrojtjen e monumenteve të kulturës nga zjarri

Çdo objekt, monument kulture, në pronësi private ose shtetërore, brenda qendrës historike të qytetit-muze të Beratit apo jashtë saj, duhet të jetë i pajisur me fikës portativë konform dispozitave ligjore në fuqi.

Bashkia e Beratit si organ i njësisë së qeverisjes vendore, administratore e qytetit, duhet të krijojë kushte për vënien në funksionim të rrjetit të hidrantëve brenda qendrës historike.

Studime për evidentimin dhe menaxhimin e riskut në qendrën historike të qytetit të Beratit hartohen nga Bashkia Berat në bashkëpunim me Institutin e Monumenteve të Kulturës dhe Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Berat dhe miratohen në KKR.

Neni 18
Komiteti për koordinimin e planeve të menaxhimit të qendrave historike Berat dhe Gjirokastër

Komiteti për koordinim dhe administrim të qendrave historike bashkërendon punën për zbatimin e kësaj rregulloreje dhe për plotësimin e rekomandimeve të vazhdueshme të UNESCO-s.

Kryetar i këtij komiteti është drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit Strategjik të Trashëgimisë Kulturore dhe Diversitetit në Ministrinë e Kulturës. Anëtarë të këtij komiteti janë Drejtorët e DRKK-ve përkatëse, kryetarët e bashkive respektive, drejtori i IMK-së dhe përfaqësues të Ministrisë së Kulturës. Përbërja e Komitetit përcaktohet me urdhër të Ministrit të Kulturës.

Ky komitet funksionon dhe mblidhet sipas rregullores, e cila miratohet në mbledhjen e parë.

Neni 19
Dispozitat e fundit

Për të gjitha çështjet që nuk trajtohen dhe për pasojë nuk zgjidhen në këtë rregullore, sipas kompetencave ato zgjidhen prej Institutit të Monumenteve të Kulturës ose Ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

Për shkeljen e kësaj rregulloreje zbatohen masa ndëshkuese sipas ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar.

Shtesat dhe ndryshimet në këtë rregullore bëhen me propozim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Kësaj rregulloreje i bashkëngjitet zonifikimi i qendrës historike dhe zonës së mbrojtur të qytetit të Beratit dhe lista e monumenteve të kategorisë së parë dhe të dytë objekteve pa status brenda qendrës historike.

Shkelja e kësaj rregulloreje shkakton përgjegjësi, sipas ligjeve në fuqi.

Neni 20
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

VENDIM
Nr. 768, datë 12.11.2014

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I VENDDEPOZITIMIT SANITAR TË MBETJEVE NË AFËRSI TË MALIQIT DHE RRUGËS HYRËSE, QARKU KORÇË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", dhe të ligjit nr. 185/2013, "Për buxhetin e vitit 2014", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i venddepozitimit sanitar të mbetjeve në afërsi të Maliqit dhe rrugës hyrëse, qarku Korçë.

2. Shpronësimi bëhet në favor të shoqërisë aksionare "Administrimi i mbetjeve të qarkut Korçë", KRWM sh.a.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë arë dhe truall, me sipërfaqe të përgjithshme prej 149 596 (njëqind e dyzet e nëntë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) m^2, si më poshtë vijon:

a) Për arë, me vlerën 31 302 436 (tridhjetë e një milionë e treqind e dy mijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë) lekë;

b) Për truall, me vlerën 2 895 070 (dy milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e shtatëdhjetë) lekë;

c) Për kultura bujqësore, me vlerën 1 808 950 (një milion e tetëqind e tetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) lekë;

ç) Për objekt, me vlerën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë.

Vlera e përgjithshme e shpronësimit është 36 021 456 (tridhjetë e gjashtë milionë e njëzet e një mijë e katërqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë.

4. Vlera përgjithshme e shpronësimit, prej 36 021 456 (tridhjetë e gjashtë milionë e njëzet e një mijë e katërqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2014, nga programi buxhetor "Menaxhimi i mbetjeve urbane", të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, për vitin 2014.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 296 000 (dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë) lekë, të përballohen nga shoqëria aksionare "Administrimi i mbetjeve të qarkut Korçë", KRWM sh.a.

6. Shlyerja e pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi.

7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZVRPP-ja", të kompensohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë, që do të dorëzojnë pranë shoqërisë aksionare "Administrimi i mbetjeve të qarkut Korçë", KRWM sh.a.

8. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi "Në proces regjistrimi", "Konfirmuar, bashkia Maliq", të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të dorëzojnë dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë shoqërisë aksionare "Administrimi i mbetjeve të qarkut Korçë", KRWM sh.a.

9. Shoqëria aksionare "Administrimi i mbetjeve të qarkut Korçë", KRWM, sh.a., të kryejë shlyerjet, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5, 6, 7 dhe 8, të këtij vendimi.

10. Brenda 30 ditëve, nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë, në bashkëpunim me shoqërinë aksionare "Administrimi i mbetjeve të qarkut Korçë", KRWM sh.a., të fillojnë procedurat për hedhjen e projektit të objektit në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t'u vihet në dispozicion nga shoqëria aksionare "Administrimi i mbetjeve të qarkut Korçë", KRWM sh.a., dhe, me fillimin e procesit të likuidimit, të fillojë edhe procesi i kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

11. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së projektit të objektit në hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

12. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave dhe shoqëria aksionare "Administrimi i mbetjeve të qarkut Korçë", KRWM sh.a. dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
Administrimi i Mbetjeve të Qarkut Korçë, KRWM. sh.a.
Sektori i Shpronësimit

LISTA E PRONARËVE DHE SIPËRFAQET PËRKATËSE TË TOKËS QË DO TË PREKEN NGA NDËRTIMI I VENDDEPOZITIMIT SANITAR TË MBETJEVE NË MALIQ DHE NGA NDËRTIMI I RRUGËS HYRËSE

Nr.	Emri	Atesia	Mbiemri	Z. K.	Numri i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. m²	Sip. për shpronësim m²	Tokë arë		Tokë truall		Kulturë bujqësore drufrutorë	Shuma totale (lekë)	Shënime
									Çmimi (lekë/m²)	Shuma (lekë)	Çmimi (lekë/m²)	Shuma			
	Fshati Shkozë, komuna Libonik, zona kadastrale 3395														
1	Dashamir	Mustafa	Petriti	3395	1746/1	Are	6035	2030	212	430360			36000	430360	Konfirmuar nga ZVRPP
2	Hamdi	Mustafa	Petriti	3395	1746/2	Are	3370	500	212	106000			0	106000	Konfirmuar nga ZVRPP
3	Edmond	Mustafa	Petriti	3395	1746/3	Are	2800	600	212	127200			9600	127200	Konfirmuar nga ZVRPP
4	Muharrem	Bektash	Petriti	3395	1746/4	Are	6780	1375	212	291500			0	291500	Konfirmuar nga ZVRPP
	Fshati Zboq, Komuna Libonik, zona kadastrale 3897														
5	Lavderim	Riza	Molla	3897	1746/27	Are	1200	1200	212	254400			19200	254400	Konfirmuar nga ZVRPP
6	Çercis	Hysni	Vila	3897	1746/1	Are	800	375	212	79500			6000	79500	Konfirmuar nga ZVRPP
7	Nevruz	Kadri	Vila	3897	1746/2	Are	800	435	212	92220			6960	92220	Konfirmuar nga ZVRPP
8	Fatmir	Nijazi	Pellumbi	3897	1746/3	Are	1800	630	212	133560			10080	133560	Konfirmuar nga ZVRPP
9	Metush	Çerçiz	Vila	3897	1746/4	Are	1040	840	212	178080			13440	178080	Konfirmuar nga ZVRPP
10	Adem	Bari	Vila	3897	1746/5	Are	800	770	212	163240			12320	163240	Konfirmuar nga ZVRPP
11	Kamber	Bari	Vila	3897	1746/29	Are	800	670	212	142040			10720	142040	Konfirmuar nga ZVRPP
13	Sefedin	Riza	Vila	3897	1746/31	Are	650	650	212	137800			0	137800	Konfirmuar nga ZVRPP
14	Guri	Xhemal	Ceta	3897	1738/1	Are	1697	500	212	106000			0	106000	Konfirmuar nga ZVRPP
	Fshat Maliq, Bashkia Maliq, zona kadastrale 1667														
15	Avzi	Hetem	Hamataj	1667	19/1	Are	1523	1523	212	322876			24360	347236	Konfirmuar nga ZVRPP
16	Irfan	Nevruz	Hamataj	1667	19/2	Are	927	927	212	196524			14840	211364	Konfirmuar nga ZVRPP
17	Robert	Nevruz	Hamataj	1667	19/3	Are	1249	1249	212	264788			20000	284788	Konfirmuar nga ZVRPP
18	Nevruz	Hetem	Hamataj	1667	19/4	Are	1215	1215	212	257580			19440	277020	Konfirmuar nga ZVRPP
19	Xhezar	Hetem	Hamataj	1667	19/5	Are	942	942	212	199704			15080	214784	Konfirmuar nga ZVRPP
20	Pellumb	Xhezar	Hamataj	1667	19/91	Are	1195	1195	212	253340			19120	272460	Konfirmuar nga ZVRPP
21	Rakip	Hafez	Beqiri	1667	19/70	Are	1800	1800	212	381600			28800	410400	Konfirmuar nga ZVRPP
22	Viktor	Hamit	Beqiri	1667	19/68	Are	1195	1195	212	253340			19120	272460	Konfirmuar nga ZVRPP
23	Fanteri	Rakip	Beqiri	1667	19/81	Are	1201	1201	212	254612			19200	273812	Konfirmuar nga ZVRPP
24	Firdus	Kadri	Beqiri	1667	19/79	Are	1210	1210	212	256520			19360	275880	Konfirmuar nga ZVRPP
25	Fredi	Kadri	Beqiri	1667	19/83	Are	2118	2118	212	449016			33880	482896	Konfirmuar nga ZVRPP
26	Teki	Kadri	Beqiri	1667	19/85	Are	1496	1496	212	317152			23920	341072	Konfirmuar nga ZVRPP
27	Hafez	Kadri	Beqiri	1667	19/89	Are	1228	1228	212	260336			19640	279976	Konfirmuar nga ZVRPP
28	Eduard	Kadri	Beqiri	1667	19/87	Are	1216	1216	212	257792			19440	277232	Konfirmuar nga ZVRPP
29	Besnik	Skender	Bezhani	1667	19/15	Are	656	656	212	139072			10480	149552	Konfirmuar nga ZVRPP
30	Adem	Adem	Myslimi	1667	19/63	Are	2118	2118	212	449016			33880	482896	Konfirmuar nga ZVRPP
31	Hasan	Kote	Hoxhallari	1667	19/67	Are	1505	1505	212	319060			24080	343140	Konfirmuar nga ZVRPP
32	Islam	Mustafa	Çakerri	1667	19/65	Are	1515	1515	212	321180			24240	345420	Konfirmuar nga ZVRPP
33	Hekuran	Qamil	Gorosella	1667	19/19	Are	1247	1247	212	264364			19960	284324	Konfirmuar nga ZVRPP
34	Fahri	Hekuran	Gorosella	1667	19/20	Are	939	939	212	199068			15040	214108	Konfirmuar nga ZVRPP
35	Vladimir	Shaban	Muço	1667	19/21	Are	1250	1250	212	265000			20000	285000	Konfirmuar nga ZVRPP
36	Hodo	Saliko	Limollari	1667	19/95	Are	3605	3605	212	764260			57600	821860	Konfirmuar nga ZVRPP
37	Nexhip	Saliko	Limollari	1667	19/97	Are	3590	3590	212	761080			57440	818520	Konfirmuar nga ZVRPP
38	Fakir	Saliko	Limollari	1667	19/62	Are	3185	3185	212	675220			50960	726180	Konfirmuar nga ZVRPP
39	Saliko	Nexhip	Limollari	1667	19/93	Are	3000	3000	212	636000			48000	684000	Konfirmuar nga ZVRPP
40	Vasil (Enver)	Saliko Limollari		1667	19/74	Are	3003	3003	212	636636			48040	684676	Konfirmuar nga ZVRPP
41	Çlirim	Taip	Limollari	1667	19/76	Are	2975	2975	212	630700			0	630700	Konfirmuar nga ZVRPP
42	Maksi	Dylber	Agolli	1667	19/28	Are	1826	1826	212	387112			29200	416312	Konfirmuar nga ZVRPP

43	Xhemil	Halim	Limollari	1667	19/29	Are	3075	3075	212	651900			49200	701100	Konfirmuar nga ZVRPP
44	KoÇi	Halim	Limollari	1667	19/30	Are	2485	2485	212	526820			0	526820	Konfirmuar nga ZVRPP
45	Petrit	Haxhi	Tabaku	1667	19/31	Are	1205	1205	212	255460			19280	274740	Konfirmuar nga ZVRPP
46	Shkelqim	Haxhi	Tabaku	1667	19/32	Are	1210	1210	212	256520			19360	275880	Konfirmuar nga ZVRPP
47	Xhevat	Ymer	Biba	1667	19/33	Are	1521	1521	212	322452			24200	346652	Konfirmuar nga ZVRPP
48	Edmont	Xhevat	Biba	1667	19/34	Are	1226	1226	212	259912			19600	279512	Konfirmuar nga ZVRPP
49	Riza	Batjar	Biba	1667	19/35	Are	1490	1490	212	315880			23800	339680	Konfirmuar nga ZVRPP
50	KoÇi	Osman	Kuka	1667	19/36	Are	1217	1217	212	258004			19480	277484	Konfirmuar nga ZVRPP
51	Metet	Neim	Biba	1667	19/37	Are	2088	2088	212	442656			0	442656	Konfirmuar nga ZVRPP
52	Çelnik	Fazlli	Kuka	1667	19/38	Are	1501	1501	212	318212			24000	342212	Konfirmuar nga ZVRPP
53	Myslim	Rushan	Kuka	1667	19/72	Are	2096	2096	212	444352			33400	477752	Konfirmuar nga ZVRPP
54	Asqeri	Besim	Bebri	1667	19/40	Are	1197	1197	212	253764			0	253764	Konfirmuar nga ZVRPP
55	Avdulla	Shuaip	Bebri	1667	19/41	Are	2148	2148	212	455376			34360	489736	Konfirmuar nga ZVRPP
56	Ilia	Ramis	Bebri (+B)	1667	19/42	Are	918	918	212	194616			14680	209296	Konfirmuar nga ZVRPP
57	Shana	Vait	Bebri (Ariflari)+B	1667	19/43	Are	921	921	212	195252			14720	209972	Konfirmuar nga ZVRPP
58	Bujar	Besim	Bebri	1667	19/44	Are	1504	1504	212	318848			24080	342928	Konfirmuar nga ZVRPP
59	Rakip	Shaqir	Zeqiri	1667	19/45	Are	1815	1815	212	384780			29040	413820	Konfirmuar nga ZVRPP
60	Bashkim	Rakip	Zeqiri	1667	19/46	Are	1230	1230	212	260760			19680	280440	Konfirmuar nga ZVRPP
61	Hiqmet	Rakip	Zeqiri	1667	19/47	Are	1219	1219	212	258428			19520	277948	Konfirmuar nga ZVRPP
62	Lume	Qamil	Yzeiri	1667	19/48	Are	596	596	212	126352			9520	135872	Konfirmuar nga ZVRPP
63	Ramadan	Mehmet	Muka	1667	19/49	Are	2128	2128	212	451136			34040	485176	Konfirmuar nga ZVRPP
64	Agim	Zenel	Ysenllari	1667	19/50	Are	1515	1515	212	321180			24240	345420	Konfirmuar nga ZVRPP
65	Gurali	Avni	Ysenllari	1667	19/51	Are	917	917	212	194404			14680	209084	Konfirmuar nga ZVRPP
66	Avni	Zenel	Hysenllari	1667	19/52	Are	1435	1435	212	304220			22960	327180	Konfirmuar nga ZVRPP
67	Bashkim	Muharem	Arapi	1667	19/53	Are	1803	1803	212	382236			28840	411076	Konfirmuar nga ZVRPP
68	Shefqet	Muharem	Arapi	1667	19/54	Are	1775	1775	212	376300			29600	405900	Konfirmuar nga ZVRPP
69	Hekuran	Sefedin	Gjyrasi	1667	19/55	Are	2070	2070	212	438840			33120	471960	Konfirmuar nga ZVRPP
70	Nevruz	Sefedin	Gjyrasi	1667	19/56	Are	1494	1494	212	316728			23920	340648	Konfirmuar nga ZVRPP
71	Bujar	Sefedin	Gjyrasi	1667	19/57	Are	1181	1181	212	250372			19000	269372	Konfirmuar nga ZVRPP
72	Enver	Sefedin	Gjyrasi	1667	19/58	Are	1193	1193	212	252916			19200	272116	Konfirmuar nga ZVRPP
74	Bardhyl	Shefit	Haxhillari	1667	25/3	Are	1504	1504	212	318848			0	318848	Konfirmuar nga ZVRPP
75	Qemal	Shefit	Hoxhallari	1667	25/2	Are	1786	1786	212	378632			0	378632	Konfirmuar nga ZVRPP
76	Isa	Muharem	Arapi	1667	25/1	Are	1776	1776	212	376512			28400	404912	Konfirmuar nga ZVRPP
77	Defrim	Zeqo	Tabaku	1667	20/1	Are	1218	1218	212	258216			19520	277736	Konfirmuar nga ZVRPP
78	Lavderim	Zeqo	Tabaku	1667	20/2	Are	609	609	212	129108			9760	138868	Konfirmuar nga ZVRPP
79	Bujar	Isa	Bashllari	1667	20/3	Are	1566	1566	212	331992			25040	357032	Konfirmuar nga ZVRPP
80	Rauf	Isa	Bashllari	1667	20/4	Are	913	913	212	193556			14600	208156	Konfirmuar nga ZVRPP
81	Arben	Rauf	Bashllari	1667	20/5	Are	1218	1218	212	258216			19480	277696	Konfirmuar nga ZVRPP
82	Jetnor	Ali	MuÇollari	1667	20/6	Are	1513	1513	212	320756				320756	Konfirmuar nga ZVRPP
83	Etem	Ali	MuÇollari	1667	20/7	Are	1531	1531	212	324572				324572	Konfirmuar nga ZVRPP
84	Pellumb	Ali	MuÇollari	1667	20/72	Are	315	315	212	66780			5670	72450	Konfirmuar nga ZVRPP
85	Agim	Ali	MuÇollari	1667	20/9	Are	1201	1201	212	254612				254612	Konfirmuar nga ZVRPP
86	Mestan	Beqir	Hoxhallari	1667	20/10	Are	1800	1800	212	381600			28800	410400	Konfirmuar nga ZVRPP
87	Guri	Mestan	Hoxhallari	1667	20/11	Are	585	585	212	124020			9360	133380	Konfirmuar nga ZVRPP
88	Bastri	Bexhe	Hoxhallari	1667	20/12	Are	1174	1174	212	248888			18800	267688	Konfirmuar nga ZVRPP
89	Petrit	Feim	Hoxhallari	1667	20/13	Are	1755	1755	212	372060			28080	400140	Konfirmuar nga ZVRPP
90	Jorgo	Hajro	Demollari	1667	20/14	Are	2081	2081	212	441172			33280	474452	Konfirmuar nga ZVRPP
91	Lytfi	Feta	Kodra	1667	20/15	Are	895	895	212	189740			0	189740	Konfirmuar nga ZVRPP
92	Perparim	Lytfi	Kodra	1667	20/16	Are	603	603	212	127836			0	127836	Konfirmuar nga ZVRPP
93	Ali	Skender	Bazelli	1667	20/17	Are	1764	1764	212	373968			0	373968	Konfirmuar nga ZVRPP
94	Medi	Skender	Bazelli	1667	20/18	Are	1171	1171	212	248252			0	248252	Konfirmuar nga ZVRPP
95	Hasan	Skender	Bazelli	1667	20/19	Are	1185	1185	212	251220			0	251220	Konfirmuar nga ZVRPP
96	Avni	Neim	Bazelli	1667	20/20	Are	885	885	212	187620			0	187620	Konfirmuar nga ZVRPP
97	Neim	Avni	Bazelli	1667	20/21	Are	1136	1136	212	240832			0	240832	Konfirmuar nga ZVRPP
98	Adriatik	Avni	Bazelli	1667	20/22	Are	1144	1144	212	242528			0	242528	Konfirmuar nga ZVRPP

99	Petrit	Muhamet	Bazelli	1667	20/23	Are	1785	1785	212	378420			0	378420	Konfirmuar nga ZVRPP
100	Bashkim	Muhamet	Bazelli	1667	20/24	Are	1183	1183	212	250796			0	250796	Konfirmuar nga ZVRPP
101	Lulezim	Muhamet	Bazelli	1667	20/25	Are	1185	1185	212	251220			0	251220	Konfirmuar nga ZVRPP
102	Dashnor	Muhamet	Bazelli	1667	20/26	Are	1204	1204	212	255248			0	255248	Konfirmuar nga ZVRPP
103	Syrja	Muhamet	Bazelli	1667	20/27	Are	879	879	212	186348			0	186348	Konfirmuar nga ZVRPP
104	Ilir	Muhamet	Bazelli	1667	20/28	Are	579	579	212	122748			0	122748	Konfirmuar nga ZVRPP
109*	Nuri	Qazim	Beqiri*	1667	23/.1	Are	1947			0			35100	35100	Konfirmuar Bashkia Maliq
110*	Artur	Qazim	Beqiri*	1667	23/.2	Are	1456	3403	212	721436			26100	747536	Konfirmuar Bashkia Maliq
Pasuritë që do të preken nga rruga hyrëse për në venddepozitimin sanitar															
Fshati Symiz, komuna Libonik, zona kadastrale 3553															
112	Kudret		Bregasi	3553	119/6	Are	1240	130	212	27560			0	27560	Konfirmuar nga ZVRPP
114	Hamet		Cuka	3553	119/2	Are	4037	300	212	63600			0	63600	Konfirmuar nga ZVRPP
TOTAL TOKË ARË								**147,653**		**31,302,436**			**1,808,950**	**33,111,386**	
								Sip. m²		Shuma arë			Kultura bujqësore		
Fshati Symiz, Komuna Libonik, zona kadastrale 3553															
116	Faik		Guri	3553	119/10	Truall	3257	350			1490	521500		521500	Konfirmuar nga ZVRPP
	Nazime		Guri												
	Muhamet		Guri												
	Stoli		Guri												
	Drita		Guri												
	Fluturak		Guri												
117	Fazlli	Qemal	Guri	3553	119/9	Truall	800	180			1490	268200		268200	Konfirmuar nga ZVRPP
118	Faik		Guri	3553	119/8	Truall	1700	370			1490	551300		551300	Konfirmuar nga ZVRPP
	Nazime		Guri												
	Muhamet		Guri												
	Stoli		Guri												
	Drita		Guri												
	Fluturak		Guri												
119	Alush		Bazelli	3553	18/164	Truall	3000	440			1490	655600		655600	Konfirmuar nga ZVRPP
	Stolie		Bazelli												
	Shyqyrie		Bazelli												
	Gani		Bazelli												
	Fluturie		Bazelli												
120	Mahmudi		Lipollari	3553	18/177	Truall	11053	550			1490	819500		819500	Konfirmuar nga ZVRPP
	Fluturie		Lipollari												
	Çelnik		Lipollari												
	Sabire		Lipollari												
	Vasfi		Lipollari												
	Mukades		Lipollari												
	Demire		Lipollari												
	Agim		Lipollari												
	Paviona		Lipollari												
123	Në proces regjistrimi			3553		Truall	4000	53			1490	78970		78970	Në proces regjistrimi
						Ndërtesë	1042	53				15000		15000	
TOTAL TOKË TRUALL								**1943**				**2910070**		**2910070**	
								Sip. m²				Shuma truall, objekt			
TOTALI								**149596**		**31302436**		**2910070**	**1,808,950**	**36021456**	
								Sip. m²		**Shuma tokë arë**		**Shuma truall**	**Kult.bujqësore**	**Shuma total**	

VENDIM
Nr. 769, datë 12.11.2014

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË DREJTËSISË TË PASURISË SË PALUAJTSHME, TË NDODHUR NË ZONËN KADASTRALE NR. 8380, ME NUMËR PASURIE 6/145, PËR GJYKATËN KUSHTETUESE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 14, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pasuritë e paluajtshme shtetërore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë të pasurisë së paluajtshme, të ndodhur në zonën kadastrale nr. 8380, me numër pasurie 6/145, me sipërfaqe trualli 859 (tetëqind e pesëdhjetë e nëntë) m^2, me sipërfaqe ndërtimi 518 (pesëqind e tetëmbëdhjetë) m^2, me adresë: rruga "Reshit Çollaku", Tiranë, në funksion të akomodimit të Gjykatës Kushtetuese, sipas kartelës dhe planvendosjes që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Objekti i sipërpërmendur të përdoret në funksion të qëllimit dhe të veprimtarisë së Gjykatës Kushtetuese.

3. Ministria e Drejtësisë nuk mund ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi dhe as ta tjetërsojë atë.

4. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Gjykata Kushtetuese dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Miratuar nga V. K. M. Nr. 519, Datë 7.11.1994

KARTELA E PASURISE SE PALUAJTSHME

Vol. 11 Fq. 248

A - SEKSIONI I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE

--> Vijon nga: Vol. Fq.

Zona Kadastrale: 8380 NR. i PASURISE: 6/145

Vijon në: Vol. Fq. deri në: Vol. Fq. -->

Indeksi i Hartës: TR; F-11

PERFUNDIMTARE (data): 17/11/2006

Adresa e pasurisë : Rrethi TIRANE Q/F TIRANA25

Rr/L RESHIT COLLAKU P/G Sh K Ap

Përshkrim i Veçantë

GJYKATA E LARTE

B - SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

Lloji i Pasurisë : TRUALL | Brenda V.K.N. : Jo --> Po. Ref : _____

Sip. Totale e Pasurisë	Nga Sip. Totale; sa Truall	Nga Sip. Truall; sa Ndërtesë
1. _____ m²	1. _____ m²	1. _____ m²
Ref _____	Ref _____	Ref _____
2. 859 m²	2. 859 m²	2. 518 m²
Ref LN 05.06	Ref LN 05.06	Ref LN 05.06
3. _____ m²	3. _____ m²	3. _____ m²
Ref _____	Ref _____	Ref _____
4. _____ m²	4. _____ m²	4. _____ m²
Ref _____	Ref _____	Ref _____

Për pjesën e përbashkët:

PALLAT

Kuota e Pjesëmarrjes: _____ %

Nr i Pasurisë (Pallat): _____

Vol. _____ Fq. _____

C - SEKSIONI I PRONESISE

Nr.Dok	Data Regjistrim	Emri Atësia Mbiemri	Nr. Pasap	I/F/B	Adresa e Pronarit	Shuma e Paguar	Data e Lësh. Certifikatës	Shënime	Firma
	10/06/2006	SHTET		I					

D - SEKSIONI I QIRAVE, NE PERDORIM, MARREVESHJEVE KUFIZUESE, SERVITUTAVE DHE INTERESAVE TE TJERA

Nr. Dok	Data e Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. të Certifikatës	Shënime	Firma

E - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TE GJYKATES, KUFIZIMEVE, etj.

Nr. Dok	Data e Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. të Certifikatës	Shënime	Firma


RR. "RESHIT COLLAKU"
7/121
7/229
7/266
7/214
7/287
7/123
7/124
7/127
7/125
7/126
7/397
7/198
7/191
6/130
6/306
6/140
6/144
6/146
6/232
6/287
6/145
6/159

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpëmdarjen në adresë).

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Adresa
Bulevardi "Gjergj Fishta",
pas ish-Ekspozitës"Shqipëria Sot",
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 36 lekë